



Npi – 01/20 datë: 28.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Si dhe në harmoni me nenin 8 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/114 të datës 26.04.2019. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.01.2021, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KODIT ETIK TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2021, e mbajtur më: 28.01.2021, unanimisht aprovoi Kodin Etik të Komunës së Shtimes.

II

Kuvendi ka marrë për bazë edhe rekomandimet e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme dhe Komitetit për Politikë e Financa, si dhe propozimet nga diskutimi publik me qytetarë.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj